



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 4, datë 23.01.2014**

**PËR**

**LICENCIMIN E Z. SHPËTIM XHETANI SI VLERËSUES I DËMEVE NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, si dhe të VKM-së nr. 164, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e Z. Shpëtim Xhetani, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin, *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)*, me afat 5 vjet, me të drejtë rinovimi, në këto grupe sigurimi të Jo-Jetës:
  - Sigurime motorike;
  - Sigurim nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkelelda SHEHI**